

RREGULLIMI KUSHTETUES I KOSOVËS NË KUADËR TË
REPUBLIKËS SOCIALISTE FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË 1945-1989-
VËSHTRIM HISTORIK

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

BEKIM KASTRATI



UNIVERSITATI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

Korrik, 2023

RREGULLIMI KUSHTETUES I KOSOVËS NË KUADËR TË REPUBLIKËS SOCIALISTE FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË 1945-1989- VËSHTRIM HISTORIK

Mentori: Prof. Dr. Ibrahim Gashi

Kandidati: Bekim Kastrati

Në këtë punim diplome do të trajtohet një temë mjaft e rëndësishme siç është “Rregullimi kushtetues i Kosovës ne kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 1945-1989, vështrim historik”. Gjatë këtij punimi është bërë përpjekje që ngjarjet që janë paraqitur në këtë punim, të bëhen në mënyrë sa më objektive dhe nga një perspektivë shumë dimensionale, duke përdorur metodat shkencore si: Analizën, Sintezën, Përshkrimin si dhe Krahasimin.

Qëllim i këtij punimi është që të paraqet në mënyrë sa më objektive dhe nga një perspektivë shumë dimensionale rregullimin kushtetues që kishte Kosova në kuadër të Jugosllavisë, nga perspektiva e një vështrimi historik. Gjatë këtij punimi do të trajtohet pozita që kishte Kosova në të gjitha kushtetutat në Jugosllavi, që nga viti 1945 deri në 1989. Në këtë punim përveç se do të trajohet aspekti kushtetues i Kosovës në të gjitha kushtetutat e RSFJ-së, që pësonin herë pas herë ndryshime, do të analizohen kushtetutat që hynë në fuqi, se ku qëndronte dallimi midis kushtetutave për Kosovën, si dhe për të përbashkëtat e tyre.

Ky punim përbëhet nga tre kapituj. Në kapitullin e parë do të trajohet në aspektin kushtetues se si u vendos që Kosova ti bashkangjitej Serbisë në Kuvendin e Prizrenit, si dhe rregullimin kushtetues të vitit 1946 për Kosovën, pastaj edhe ndryshimin kushtetues të vitit 1953. Në kapitullin e dytë do të trajtohet Kosova në kushtetutën e vitit 1963, pastaj impakti që kishte Plenumi i Brioneve në rrjedhjen e ngjarjeve të më pastajshme. Në Kapitullin e tretë do të trajohet perioda e fillimit të ndryshimeve kushtetuese 1968-1974, Kushtetuta e vitit 1974, Demonstratat e vitit 1981, tendencat pas vitit 1981 për suprimimin e autonomisë së Kosovës.